



Nr 1759 prot
Data 05.06.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

**SHPALLJE
PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIM CIVIL
NË PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Specialist I dhunes ne familje , niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. Vendim Nr. 243, datë 18.03.2015 I ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive Bashkia Përmet shpall procedurën për plotësimin e vendeve të lira për pozicionin :

Specialist Kulture/Arsim/Sport

Kategoria IV-4

1 vend vakant

. Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LEVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

13.06.2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

19.06.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Jep hollësi për procesin e hartimit, zhvillimit të politikave kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Koordinon zbatimin e tyre me institucione të tjera shtetërore dhe organizata joqeveritare;
- Jep hollësi për hartimin e procedurave, standardeve dhe protokolleve lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Kontribuon në hartimin e ndryshimeve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- Mbështet dhe mbikëqyr krijimin e qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje dhe ato të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe bën licensimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;
- Harton raporte periodike për progresin, sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin në zbatimin e politikave për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

1 LËVIZJA PARALELE

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në një nga degët e Arsimit të Lartë në Shkencat Shoqërore
- b- Të ketë eksperience pune të paktën 1 vit në administratën publike .
- c- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
- d- Të ketë njohuri të mira të programeve kompjuterike baze

Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Përmet dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje e noterizuar e diplomës/listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Zyrën e Administratës së Bashkisë Përmet me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri ", kati katërt brenda datës 13.06.2025.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx
- b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f – Vërtetim për gjendjen gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet pranë Zyres së Administratës të Bashkisë Permet.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 19/06/2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20/06/2025, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervistë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Administratës, për shkaket e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 9669/2018 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 104/2012 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 327, datë 02.06.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si

dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 400 datë 30.06.2021, " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

BASHKIA PERMET

